



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. dhe 1.5., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, më datën 30.05.2023, nxjerrë këtë:

Dep.	Nr. Prot.
Dsp.	Br. Prot.
Dsp.	Prot. No.
Nr. Fiq.	Data
Br. Str.	Datum
Nr. Page.	Dati
	PRANDHË E

06/02 1149/23
02 01-06-2023

V E N D I M

Mbyllet rasti me nr. APK-DPKI-06-5006/22, për zyrtarin e lartë z. Merxhan Avdyli, Dekan i Fakultetit të Edukimit në Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Merxhan Avdyli, Dekan i Fakultetit të Edukimit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka pranuar informatën nga raportuesi i jashtëm (DPKI/06-5006/22), me pretendimet për konflikt të interesit në rastin e z. Merxhan Avdyli, i cili në cilësinë e dekanit të Fakultetit të Edukimit ka marrë pjese në vendimmarrje në konflikt të interesit me rastin e nxjerrjes së Vendimit nr. 1117. i datës 15.07.2022, për formimin e Komisionit Recensues lidhur me konkursin Ref.nr.01/1125 i datës 12.07.2022, për angazhimin e personelit akademik, ku vetveten e ka caktuar si kryetar të këtij komisioni.

Sipas shkresës së raportuesit të rastit, i njëjti përveç pretendimit për konflikt të interesit si më lartë, ka ngritur edhe pretendime tjera lidhur me (pa)rregullsi në procesin e rekrutimit sipas konkursit të sipërpërmendur, si dhe pretendime tjera të cilat janë jashtë sferës së konfliktit të interesit që nuk mund të lidhen me vendimmarrje për interes privat, porse kanë të bëjnë me rregullativën e brendshme ligjore të universitetit në fjalë.

Andaj, Agjencia konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, respektivisht nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., ka zhvilluar hetimin administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimin për konflikt të interesit me rastin e nxjerrjes së Vendimit nr. 1117. i datës 15.07.2022, dhe atë në kuptim dispozitive të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit që kanë të bëjnë me vendimmarrjen për interes privat.



Lidhur me këtë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka njoftuar zyrtarin lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPKI-06-217/22), si dhe e ka njoftuar me pretendimet e ngritura.

Me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar nga Universiteti “Kadri Zeka”, dokumentacionin relevant dhe informacione përkitazi me komisionin recensues dhe kompensimin e anëtarëve të këtij komisioni (DPKI-06-376-1/23)

Pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant dhe informatave të siguruar nga universiteti (DPKI-06-376-2/23), Agjencia ka gjetur se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për konflikt të interesit në frymën e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kjo për faktin se:

Pretendimi në fjalë për konflikt të interesit, respektivisht, nxjerrja e Vendimit nr. 1117. i datës 15.07.2022, nga z. Avdyli përmes së cilit e ka caktuar vetën si kryetar të komisionit, është trajtuar nga këndvështrimi i përfitimit eventual personal duke qene anëtar i komisionit në fjalë, e që lidhet me “konfliktin e interesit” sipas dispozitës së nenit 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, sipas së cilës, *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”*, si dhe “vendimmarrjen” e cila sipas nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, përcaktohet si *çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.*

Sipas sqarimit të dhënë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit “Kadri Zeka”, *“anëtarët e komisionit recensues të formuar sipas vendimit nr. 1117 të datës 15.07.2022, nuk janë kompensuar konform nenit 9 të rregullore nr. 01/1473 të dt. 09.07.2021, për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm me honorar në UK, (Universiteti sipas rregullores financon vetëm komisionet recensues për pranimin e stafit në marrëdhënie të rregullt pune)”*. Një gjë e tillë është dëshmuar edhe përmes dokumentacionit përkatës nga ana e universitetit.

Lidhur me pretendimin e raportuesit të rastit, se dy kandidatet e pranuar janë me prejardhje nga Komuna e Vitisë, prej nga vjen edhe z. Avdyli, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka informata për afërsinë familjare të personave në fjalë dhe kësisoj nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimit në fjalë.

Andaj, nga sa u tha më lartë, në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshka
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

